

INICIATIVAVE E BURRAVE TË RINJ

PROGRAMI Y – Qasjet inovative në parandalimin e DHBGj dhe promovimin e jetesës së shëndetshme për djemtë dhe vajzat e reja

Future 4 YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net

Programi CARE për arsimimin transformues gjinor (YMI – Iniciativa e Burrave të Rinj) është një sukses i dëshmuar në Ballkanin Perëndimor. Bërthama e Programit YMI është Programi Y i cili fokusohet në transformimin e mjedisit shkollor në një mjedis që mbështet dhe zhvillon barazinë gjinore si dhe promovon një kulturë të mos-dhunës. Programi është pilotuar, vlerësuar dhe akredituar në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kurrikula është zbatuar nga edukatorët bashkëmoshatar, punëtorët rinor dhe edukatorët si pjesë e krijimit të efektit të "shumëfishimit". Ky fokus është bazuar në të kuptuarit që adoleshenca paraqet një moment të rëndësishëm në procesin e socializimit, kur edhe qëndrimet ndaj dhunës dhe roleve gjinore formulohen dhe forcohen, si dhe të kuptuarit që shkollat janë një institucion i rëndësishëm në ndërtimin dhe përforcimin e normave gjinore.

Ky është program për shkollat e mesme që janë në kërkim të një kurrikule transformuese në aspektin gjinor për parandalim të dhunës, si mjet efektiv dhe i dëshmuar i cili ofron njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme për të punuar me nxënësit në temat e barazisë gjinore dhe parandalimit të dhunës. Programi synon të gjithë djemtë dhe vajzat e reja të cilët nuk kanë qasje në një program arsimor për shkathtësitë e jetës që do të lehtësonte kalimin e shëndetshëm nga adoleshenca në moshë madhore.

MODELI PËRBËHET PREJ DISA FAZAVE:

- 1 Prezantimin e programit para anëtarëve të bordit të shkollës, këshillit të prindërve dhe mësimdhënësve
- 2 Prezantimin e programit para nxënësve të shkollave të mesme përmes fushatave lansuese
- 3 Vlerësimin e gjendjes fillestare të njohurive, aftësive dhe statusit social të nxënësve
- 4 Trajnimi për mësimdhënësit – trajnim 3 ditor për kurrikulën dhe metodologjinë e Programit Y, me konsultime dhe mbështetje teknike, si një proces i vazhdueshëm përgjatë zbatimit të programit.
- 5 Punëtoritë edukative për nxënësit
- 6 Fushata sociale që ndjekin temat e punëtorive si dhe veprime në rrugë dhe shkolla lokale të zhvilluara dhe zbatuara nga nxënësit, me mbështetjen e stafit shkollor dhe prindërve.
- 7 Vlerësimi i gjendjes në fund të programit – matja e ndikimit

Teoria e ndryshimit e Programit YMI është se nëse nxënësit mësojnë të njohin normat e dëmshme gjinore, dhe ju ofrohet një hapësirë e sigurt për të vënë në dyshim këto konstrukte, atëherë ka më shumë gjasa që ata të brendësojnë ide të reja që janë në mbështetje të barazisë gjinore, sjelljeve të shëndosha dhe jo të dhunshme.

Gjatë viteve të zbatimit, nxënësit

që kanë marrë pjesë programin e plotë

Programi Y, përjetuan si më poshtë:

- Ndryshim pozitiv të qëndrimeve deri në **20%** në lidhje me rolet gjinore, normat gjinore, dhunën dhe njohuritë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues.
- **80%** e tyre konfirmuan se punëtoritë e YMI kishin ndikuar në një masë të madhe në zgjidhjen e konflikteve pa përlëshje, të folurit për seks të sigurt, shmangien e alkoolit dhe drogës, dhe kërkimit të ndihmës në rast të ndonjë problemi.
- Dhuna fizike mes djemve zvogëlohet për deri në **21%** në disa komunitete dhe deri në **8%** në mesin e vajzave.
- Pas intervenimit, ka ndryshime pozitive në qëndrimet ndaj DHBGj, që shkon deri në **30%** në disa raste.
- Programi parandalon "soditësit", ku pas intervenimit, shumica dërmuese e djemve të rinj dhe veçanërisht vajzave të reja theksojnë se do të përpiqeshin të ndalnin dhunën, nëse do ta shihnin se po ndodhte në mjediset e tyre.

YMI ka marrë çmimin
GENE Innovation AWARD
NË VITIN 2017 TË NDARË
NGA "Global Education
Network Europe"


INICIATIVAVE E BURRAVE TË RINJ

PROGRAMI Y – Qasjet inovative në parandalimin e DHBGj dhe promovimin e jetesës së shëndetshme për djemtë dhe vajzat e reja

Future 4 YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net



Deri më tani, **Programi Y** është zbatuar si pjesë e kurrikulës zyrtare shkollore dhe programit jashtë-kurrikular në 130 shkolla të mesme në Ballkanin Perëndimor. **120,000 nxënës të shkollës së mesme dhe 1,600 mësues u edukuan në kuadër të kësaj iniciative.**

CARE dhe partnerët e saj në të gjithë Ballkanin kanë iniciuar lëvizjen "**Future 4 Youth (E ardhmja për të rinjtë)**", e cila synon të bashkojë zëra të ndryshëm të shoqërisë civile, grupeve joformale të qytetarëve, prindërve, mësuesve dhe akterëve të tjerë rreth të njëjtit qëllim - adresimin dhe avokimin për parandalimin e dhunës, barazinë gjinore, shkathtësitë jetësore dhe edukimin shëndetësor në shkolla, në të gjithë Ballkanin.


KONTAKTONI

Për më shumë informata na kontaktoni në **info@youngmeninitiative.net**

- <https://youngmeninitiative.net/en>
- <http://care-balkan.org/>
- <https://www.facebook.com/youngmeninitiative>
- <https://www.instagram.com/yminiinitiative>

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

Mbështetur nga:



With funding from
Austrian
Development
Cooperation



Partnerët:

